



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 55, Datë 22.02.2021

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ARIS ALBANIA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GURI I ZI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 KW, HEC “DAZNJANË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 KW, DHE HEC “SHËLLI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 KW, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 13, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/8 prot., datë 21.02.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 31, datë 04.02.2021, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kW, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kW, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kW, me kapacitet total të instaluar 4755 kW, për një afat 30 vjeçar”.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me “Njoftimin për Licencim” nr. 6/7 prot., datë 04.02.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ARIS ALBANIA” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 109/1 prot., datë 12.02.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe me qëllim marrjen e një vendimi final nga ana e ERE-s për

këtë aplikim, bëri me dije nevojën e depozitimit në ERE të dokumentacionit të konstatuar i munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit të bordit të ERE nr. 31/2021.

- Shoqëria “ARIS ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109/2 prot., datë 16.02.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të *Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e *Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
  - Dokumentacioni teknik për HEC, Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 4.1.4, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”. **Plotësuar.**
  - Leje nga institucione të tjera, Neni 9, pika 4.1.5, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 27.04.2022), me nr. 99 prot., datë 08.05.2017, për HEC-in “Daznjanë”, nr. 100 prot., datë 08.05.2017, për HEC-in “Guri i Zi” dhe nr. 101 prot., datë 08.05.2017 për HEC-in “Shëlli”, do t’i kërkohet shoqërisë që t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.
- Në përfundim të Afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat, (data e përfundimit 16.07.2021) do t’i kërkohet shoqërisë t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Kontrata nr. 2638 REP., nr. 1242/3 KOL., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Guri i Zi”, me kapacitet prodhues 1719 kW, në pjesën e sipërme të lumit të Kurvajt dhe në degët e tij, Bashkia Mat, Qarku Dibër”; Kontrata nr. 2639 REP., nr.

1243 KOL., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Daznjanë”, me kapacitet prodhues 1518 kW, në përroin e Daznjanës, i cili derdhet në lumin e Kurvajt, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzez Bashkia Mat, Qarku Dibër”; Kontrata nr. 2440 REP., nr. 1244/3 KOL., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Shëlli”, me kapacitet prodhues 1518 kW në përroin e grykës së Shëllit, i cili derdhet në lumin e Kurvajt, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, Qarku Dibër”, të lidhura midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., kane një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38, të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kW, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kW, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kW, me kapacitet total të instaluar 4755 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 27.04.2022), me nr. 99 prot., datë 08.05.2017, për HEC-in “Daznjanë”, nr. 100 prot., datë 08.05.2017, për HEC-in “Guri i Zi” dhe nr. 101 prot., datë 08.05.2017 për HEC-in “Shëlli”, shoqëria “ARIS ALBANIA” sh.p.k., t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.
3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat, (data e përfundimit 16.07.2021), shoqëria “ARIS ALBANIA” sh.p.k., t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**